



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 08

Datë: 19. 04. 2019. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 07/2019
2. **Aktivitetet e ZRPPC-së;**
3. **Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
4. **Raport i Këshillave të KQZ-së;**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operativ të Sigurisë për e Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan, që do të mbahen më 19 maj 2019.
 - **Këshilli i Personelit:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për rritjen e numrit të stafit jo permanent për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan, që do të mbahen më 19 maj 2019.
 - Shqyrtimi dhe miratimi i përkrahimit të vendit të punës për pozitat në SKQZ;

5. Të ndryshme:

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KOZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje. E kemi rendin e ditës...! A dikush vërejtje, propozim...?

Në fakt e kemi një kërkesë nga anëtari Stevan Veselinoviq. Nëse mund ta fusim në rend dite?

Florian Dushi: E kemi shqyrtuar në KOZ, dhe mund ta shqyrtojmë në pikën e rendit të ditës të KOZ-it...

Valdete Daka: Mirë, kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr.07/2019

Valdete Daka: Tash e kemi miratimin e procesverbalit nr. 8. A ka vërejtje ? Nëse jo, kush është për miratim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nr.07/2019

3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ: Faleminderit. Sekretariati ka vijuar me aktivitetet e veta në funksion të realizimit dhe përmbushjes së të planit operacional. Janë mbajtur takimet e para me anëtarët e KKZ-ve, po ashtu janë bërë furnizimet me materiale zgjedhore, dhe në aspekt teknik në bashkëpunim janë duke vijuar aktivitetet: me policinë dhe aktorët e tjerë, kemi hartuar Planin Operacional. Është bërë përgatitja dhe modifikimi i aplikacionit - Makinës Kërkuese, Azhurnimi i bazës së të dhënave të votuesve në Qendrat e Votimit, si dhe është testuar funksionaliteti i Makinës Kërkuese. Që nga krijimi i listës preliminare të Votuesve, janë bërë përgatitjet të nevojshme për fillimin e periudhës së Shërbimit Votues që, do të realizohet nga data 23 – 29 prill. Divizioni përkatës, ka bërë shtypjen e listave preliminare, dhe sipas planit do të procedohen nëpër qendrat përkatëse të votimit.

Periudha për Aplikim për Votim Jashtë Kosovës, do të filloj me 25 prill, dhe do të përfundoj 30 prill, dhe jemi në përgatitje të fillojë edhe kjo fazë...

Numri i votuesve jashtë Kosovës që do të ftohen për votim, është 724 sipas komunave...Janë përfshirë edhe pikat shpërndarëse në realizim të këtij plani. Sipas planit,

sot është duke u mbajtur “Program Oriënutes” për KKZ-të me një prezencë solide të anëtarëve tashmë, të emëruar...

Është bërë përgatitja e materialeve për informim publik, për atë sa lejojnë kushtet tona për këto zgjedhje, dhe ato po shkojnë e po transmetohen në media...! Po bëhet përgatitja për staf për këto zgjedhje. Sfidë, e kemi miratimin e vonuar të buxhetit, dhe kjo interferon në punën e prokurimit për shkak të rrjedhjes së kohës...

Adnan Rrustemi: Sa i parkete makinës kërkuese, nuk do të thotë domosdoshmërishtë kjo të lidhet me periudhën e shërbimit votues, por nëse është gati le të lansohet sa më parë. Është një mjet votimi, dhe asgjë tjetër. Mbase, ju shërben edhe subjekteve politike. Por, e kam një pyetje lidhur me një shkresë për nënkryetarët e komunave...?

Enis Halimi: Është kërkesë për plasim të materialeve informative..

Ercan Spat: Në raportin e tij, kryeshefi përmendi afatet kohore si sfidën kryesore. Në rrethana të këtilla, a po mban Sekretariati takimi. Sepse, disa çështje që janë të Sekretariatit, po trajtohen nëpër këshilla...

Enis Halimi: Po, Sekretariati mban takime të rregullta me menaxhmentin, dhe me të tjerë sektorë që është e nevojshme...

4. Aktivitetet e ZRPPC-së

Valmira Selmani, u.d. e ZRPPC: Zyra në bazë të miratimit të planit operacional, ka zhvilluar aktivitetet dhe i ka informuar subjektet politike për aplikim të tyre për certifikim, po ashtu i kemi njoftuar lidhur me vendim të miratuar tashmë nga KQZ lidhur me përkufizim të shpenzimeve për fushatë zgjedhore si dhe me numrin e votuesve për komunat zgjedhore, kemi komunikuar edhe me PZAP për gjobat e subjekteve politike që i kanë ato gjatë fushatave zgjedhore të kaluara...

Dje, ka qenë afati i fundit për certifikim të subjekteve politike i cili afat është përmbyllur. Kanë aplikuar tri subjekteve politike...I keni tabelat, raportet...Zyra, është duke e kontrolluar dokumentacionin...

Sami Hamiti: A janë shqyrtuar kandidatët, a kanë zotësi juridike për të marrë pjesë në zgjedhje...? Sa prej tyre janë të atillë që kanë dhënë dorëheqje dhe, përsëriten prapë...?

Valmira Selmani: Zyra, i ka dërguar listat për tu verifikuar nëse gjenden në listën votues, dhe janë banorë të Kosovës. Nga data baza kemi marrë konfirmimin se gjenden në listën votuese.

Sa prej tyre kanë dhënë dorëheqje dhe, eventualisht garojnë, këtë ende nuk e kemi konfirmuar. Por, sot do ta kemi edhe këtë konfirmim nga data baza...

Sami Hamiti: Tre e dimë që janë, e që kanë dhënë më herët dorëheqje...Të analizohet më thellë çështja e tyre në KQZ...

Adnan Rrustemi: Ne kemi një njoftim nga aktivitetet e ZRPP, e besoj se së shpejti do ta kemi edhe raportin e zyrës...Pajtohem, në rastin konkret duhet ti shqyrtojmë këto sepse, situata përmes së cilës kemi ardhur në një situatë të jashtëzakonshme, duhet të analizohet...! Nuk kam asgjë kundër serbëve, as kundër atyre që votojnë, atyre që kandidojn por, ne duhet ta dimë që edhe qytetarët serbë kanë nevojë për qeverisje, dhe që kjo u është mohuar për gjashtë muaj rresht nga të dorëhequrit...

Unë mendoj që kur të na vinë në mbledhje emrat e kandidatëve, ne duhet t'i diskutojmë ata, por mendoj që duhet të vëmë një komunikim edhe me Ministrinë e Pushteti Lokal: duhet t'i kërkojmë dorëheqjet (letrat) e këtyre kandidatëve që s'ish e përmendi kolegu, tre prej tyre kanë qenë kryetar...Arsyet, format e dorëheqjeve...

Jemi institucion shtetërorë – kushtetues. Ne, si anëtarë, duhet t'i plotësojmë funksionet tona me punën që bëjmë, ne nuk jemi një lloj ishulli i izoluar...Mendoj që KQZ e ka një rast të mirë , para se të marrim vendim, për ti disiplinuar kandidatët, pra edhe kandidatët e Listës Serbska për sjelljet dhe veprimet e tyre të fundit, pra në kursin dhe respektimin e legjislacionit, kushtetutshmërisë, përgjegjësisë në raport me institucionin...

Nuk mund ta kapërcejmë problemin teknikisht, por duhet të sillet dokumentacion shtesë...

Florian Dushi: Për aq sa pamë, kemi të bëjmë me një njoftim teknik, jo më shumë. Unë, duke u pajtuar me shqetësimet e kolegëve lidhur me ata persona që janë edhe shkaktarë të këtyre zgjedhjeve, kanë provokuar këto zgjedhje...Të mos ngutemi, njëherë ti presim rekomandimet e zyrës...ajo sjell dokumentacion për secilin kandidat, dhe të shohim nëse të njëjtit i plotësojnë kushtet...Mendoj që është një mundësi e mirë që në këtë fazë, zyrës ti tërhiqet vërejtja dhe, në detaje ti zbatohet kriteret ligjore dhe kushtetuese për të na dhanë mundësi edhe ne, që të diskutojmë...

Të shohim, nëse dorëheqjet e tyre janë pengesë dhe që, të njëjtit të kandidojnë përsëri...

5. Raport i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operativ të Sigurisë për e Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan, që do të mbahen më 19 maj 2019.

Adnan Rrustemi: KOZ ka shqyrtuar draft – planin e sigurisë të përgatitur nga Sekretariati, dhe ky dokument është dokument përmbledhës... Policia, tashmë është e përfshirë...! Prandaj, e rekomandojmë për rekomandim këtë draft – plan.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë draft – plan.

Ercan Spat: Unë, kam marrë edhe telefonatë prej kolegut Veselinoviq lidhur me kërkesën e tij për zgjatjen e afatit lidhur me regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës. Sipas tij, deri më 7 maj, dhe kjo për shkak të disa festave fetare...

Enis Halimi: Ka qenë e paraparë prej 25 – 30 prill, dhe nëse ne e lëvizim këtë datë periudha e Sfidimit dhe Kundërshtimit, do të konsumohej...Dhe se ne, mund ta shtyjmë prej 23 – deri më 30 prill...

Sami Hamiti: Nuk e kemi rastin e parë, prandaj të mos krijojmë precedan që të lëvizim data të afateve...Në rregull, meqë janë Pashkët por, të mos bëhen precedane...

Adnan Rrustemi: Ndërhyrja në një operacion, implikon operacione tjera...E kuptoj arsyen, por edhe unë mendoj që nuk duhet të krijohet një standard për ndryshim të datave që, ne i kemi miratuar në planin operacional...

Megjithatë, pajtohem që ta zgjasim afatin: jo në fund të tij, por në fillim të tij...Por, kërkoj që të respektohet rregullativa, procedurat dhe jo, si në të kaluarën që na janë sjellë pako jashtë procedurave...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për që, kjo datë të fillojë më 23 prill, dhe të përfundoj më 30 prill...

Anëtarët e KQZ –së, miratuan këtë rekomandim.

2. Këshilli i Personelit:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për rritjen e numrit të stafit jo permanent për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan, që do të mbahen më 19 maj 2019.

Florian Dushi: Kemi një kërkesë për rritjen e një numri tjetër të stafit shtesë...! Kur e kemi shqyrtuar buxhetin, kemi kërkuar që të kemi një staf të reduktuar jo permanent. Megjithatë,

kemi kërkesë për shtim të këtij numri, sidomos në segmente më të theksuara, dhe mendoj që kjo nuk ka implikim të veçantë në buxhet...

Valdete Daka: A ka dikush vërejte, plotësim etj. Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për rritjen e numrit të stafit jo permanent.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i përshkrimit të vendit të punës për pozitat në SKQZ:

Florian Dushi: Kjo çështje, ka të bëjë me përshkrimin e detyrave të punës, sa i përket pozitës së udhëheqësit të Divizionit për Informim dhe Edukim të Votuesve. Në këshill të personelit, kemi kërkuar që të futen edhe të tjera drejtime kualifikuese shoqërore...Prandaj, kërkoj nga Sekretariati që kjo të rregullohet saktësisht...